
**SUPPORTING SMALL AND MEDIUM ENTERPRISE AND ENTREPRENEURSHIP -
THE CASE OF NORTH MACEDONIA**

Elmedina Shuajibi

International University of Struga, Struga, Republic of N. Macedonia, e.shuajibi@eust.edu.mk

Merita Saliu

University of Tetovo, Tetovo, Republic of N. Macedonia, s.merita92@gmail.com

Miranda Rahmani

International University of Struga, Struga, Republic of N. Macedonia, miranda.rahmani7@gmail.com

Abstract: In a market economy, under conditions of severe competition, the only surviving and developing enterprises are the ones that adapt to market demands and invest in production factors and especially the entrepreneurial factor. Small and medium-sized enterprises and entrepreneurship have a very important economic and social role because of their contribution to economic growth, economic development, GDP growth, and export and in creating new working positions. The role, importance and impact of SMEs on economic and social development varies depending on the level of overall economic development and the type of economic system itself. The market economy dominated by private property, where supply and demand operate, where there is full competition and high levels of unemployment, there is a growing need for entrepreneurial spirit and the development of small and medium sized businesses. For the analysis of SMEs and entrepreneurship in the RNM it is necessary to note that small business is essentially a form of market economy. The notion of SMEs is a new notion that has been known only in developed western countries. With the first law regarding enterprises, which was adopted in 1988, strengthened activity began in support of SMEs and entrepreneurship. The measures and instruments in support of entrepreneurship are dedicated to improving the factors that are a limiting element of SME development by creating the conditions for private property and entrepreneurship development. Creating such conditions enables the establishment of a large number of shops and private SE. This phenomenon is followed by the great entrepreneurial desire for business ideas to be transformed into business activities with the aim of securing a higher position in society with own their capital and private enterprise.

Keywords: entrepreneur, SME, economic growth, private property, market.

**PËRKRAHJA E SIPËRMARRËSISË DHE NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË
MESME - RASTI I MAQEDONISË SË VERIUT**

Elmedina Shuajibi

International University of Struga, Struga, Republic of N. Macedonia, e.shuajibi@eust.edu.mk

Merita Saliu

University of Tetovo, Tetovo, Republic of N. Macedonia, s.merita92@gmail.com

Miranda Rahmani

International University of Struga, Struga, Republic of N. Macedonia, miranda.rahmani7@gmail.com

Abstract: Në ekonomin e tregut, nën kushtet e një konkurrence të ashpër, mbijetojnë dhe zhvillohen vetëm ato sipërmarrje të cilat i përshtaten kërkesave të tregut dhe investojnë në faktorët e prodhimit e veçanërisht në faktorin sipërmarrës. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe sipërmarrësia kanë një rrol shumë të rëndësishëm ekonomik dhe social, përshkak të kontributit të tyre në rritjen ekonomike, në zhvillimin ekonomik, në rritjen e GDP-së, në eksport dhe në krijimin e vendeve të reja të punës. Roli, rëndësia dhe ndikimi i NVM në zhvillimin ekonomik dhe social ndryshon varësisht nga niveli i zhvillimit të përgjithshëm ekonomik dhe nga vet lloji i sistemit ekonomik. Në ekonominë e tregut ku dominon prona private, ku vepron oferta dhe kërkesa, ku ka konkurrencë të plotë dhe nivel të lartë të papunisë, rrit domosdoshmërinë për shfaqjen e frymës sipërmarrëse dhe për zhvillimin e bineseve të vogla dhe mesme. Për analizën e NVM dhe sipërmarrësisë në RMV është e domosdoshme të theksohet se biznesi i vogël paraqet në thelb fomë e ekonomisë së tregut. Nocioni i NVM së është nocion i ri i cili ka qenë prezent vetëm në shtetet e zhvilluara perëndimore. Me ligjin e parë mbi sipërmarrjet, i cili u soll në vitin 1988, filloi aktiviteti i forcur në mbështetjen e NVM dhe të sipërmarrjeve. Masat dhe instrumentet për përkrahjen e sipërmarrësisë i dedikohen përmirësimit të faktorëve që paraqesin element kufizues për zhvillimin e NVM duke u krijuar kushtet për zhvillimin e pronës private dhe sipërmarrësisë. Krijimi i kushteve të tilla mundëson themelimin e një numri të madh dyqanesh


dhe NV private. Këtë fenomen e ndjek dëshira e madhe sipërmarrëse që idetë binzesore të shëndrohen në aktivitetet afariste që me kapitalin vetanak dhe sipërmarrjen private të sigurohet një pozitë më e lartë në shoqëri.

Fjalët kyçe: sipërmarrësi, NVM, rritje ekonomike, prona private, tregu.

1. HYRIJE

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) dhe sipërmarrësia kanë një rol ekonomik dhe social shumë të rëndësishëm, për shkak të kontributit të tyre në funksionimin e rrjetit ekonomik dhe në krijimin e vendeve të punës. Këto kontribute janë shumë të vlefshme në kushtet e krizës dhe të rritjes së papunësisë. Ambienti mw I pwrshatatshwm pwr zhvillimin e NVM dhe tw sipwrmarrwsisw wshtw ekonomia e tregut, njw ekonomi e hapur pwr hyrje dhe dalje tw lirshwm tw sipwrmarrjeve nw degw tw ndryshme tw ekonomisw si dhe veprim i lirshwm I konkurrencws sw plotw. Krijimi I njw ambienti tw pwrshatatshwm ndikon nw nxitjen, zhvillimin dhe pwrkrahjen e frymws sipwrmarrwse nw njw shtet apo shoqwri. Roli, rëndësia dhe ndikimi i NVM në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe social të vendeve në të cilat ka vepruar, ndryshon varësisht nga niveli i zhvillimit të përgjithshëm ekonomik dhe nga vetë lloji i sistemit ekonomik. Si NVM prodhuese ashtu edhe ato shërbyese vazhdimisht kanë përfaqësuar subjektet ekonomike me tipare të ekonomisë së tregut. Prona private, liria e iniciativës si dhe ambienti i tregut paraqesin hapsirën më të përshtatshme për zhvillimin e vazhdueshëm dhe të papenguar të tyre. Andaj këto sipërmarrje zhvillimin më të hovshëm dhe më ndikues e kanë në ekonomitë e tipit të tregut. Rritja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) është komponent thelbësor i zhvillimit ekonomik. NVM-të zakonisht janë burim i konsiderueshëm punësimi dhe ndihmojnë në stimulimin e novacionit, dinamizmit ekonomik dhe konkurrencës. Mbi 90% e bizneseve janë NVM, dhe përgjithësisht shërbejnë si motori më i madh i hapjes së vendeve të punës në ekonomitë në zhvillim dhe në tranzicion, shpesh duke përfaqësuar mbi 60% të vendeve të punës. Shumica e kompanive kanë personel më pak se 100 vetë. Një studim për 60 000 persona me të ardhura të pakta në më tepër se 50 shtete, tregoi se hapja e një biznesi të ri konsiderohej si metoda më efiçase për t'i shpëtuar varfërisë (Figura 1).

Figura 1. Përceptimi i rrugëve efektive për të dalë nga varfëria (% e të anketuarve)



Shënim: bazuar në intervistën e 60 000 njerëzve të varfër në më shumë se 50 shtete.

Burimi: Narayan dhe të tjerë (2000)

Zhvillimi i ndërmarrjeve të reja sjell njerëz të rinj në fuqinë punëtore, shton tatimpagues të rinj, produkte dhe shërbime në tregjet vendëse, rajonale dhe globale. “NVM-të janë burim punësimi, konkurrence, dinamizmi ekonomik dhe novacioni; ato stimulojnë shpirtin sipërmarrës dhe përhapjen e aftësive. Për shkak se gëzojnë prani gjeografike më të gjerë sesa kompanitë e mëdha, NVM-të kontribuojnë edhe në shpërndarjen më të mirë të të ardhurave. Tabela 1.1 tregon rolin jetik që luan sektori i NVMve në ekonomitë në zhvillim. NVM-të japin kontributin më të lartë në PBB dhe punësim në shumicën e vendeve të zhvilluara të botës si SHBA, Japonia, Gjermania, Franca, Italia dhe Britania e Madhe.

2. NVM DHE SIPËRMARRËSIA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Sektori i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përfshin 98% nga numri i tërësishëm i ndërmarrjeve ekzistuese dhe është faktor i rëndësishëm i rritjes ekonomike me rreth 68% pjesëmarrje në BPV dhe dy të tretat e të punësuarve. Si i tillë, ai paraqet prioritet themelor i politikave ekonomike të Qeverisë së RM të orientuara drejt rritjes së konkurrencës së ekonomisë maqedonase. Deri tani në Republikën e Maqedonisë³⁴⁰ janë implementuara më tepër

³⁴⁰<http://www.konkurentnost.mk/Alb/OblastiDetailVieëSq.aspx?oblastId=2>

aktivitete reformuese në funksion të zhvillimit të sipërmarrësish dhe të NVM në fushat vijuese: thjeshtësimi dhe zvogëlimi i tatimeve, regjistrimi i shpejtë dhe i thjeshtë i nismës së re afariste, thjeshtësimi i procedurave administrative, zvogëlimi i shpenzimeve dhe i dokumenteve për punë afariste (gjytina rregullatore) dhe lehtësim i qasjes në mjetet për financim të investimeve. Njëkohësisht, përmes projekteve dhe programeve përkatëse me mjete buxhetore dhe donatore, realizohen aktivitete dhe masa për përkrahje të sipërmarrësish dhe NVM, me theks të posaçëm në dialogun e vazhdueshëm publik – privat. Edhe krahas kësaj, janë të nevojshme aktivitete të mëtejme për përmirësimin e rezultateve të sektorit të NVM në funksion të rritjes dhe zhvillimit të tyre më të shpejtë, shuma më të mëdha të investimeve dhe eksport të rritur. Masat e përkrahjes të ndërmarrjeve zbatohen në dy programe bartëse për përkrahje dhe zhvillim të NVM të implementuara nga Ministria e ekonomisë dhe Agjencisë për promovim të sipërmarrësish APSRM. Vizioni i Strategjisë Kombëtare për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme 2002-2013 është rritja e punësimit dhe pjesëmarrja e kësaj kategorie në BPV (Bruto Prodhimi Vendor), ndërsa përqëndrimi është i orientuar drejtë qëllimeve vijuese përmes të cilave zbatohet vizioni: përmirësim i politikave, e drejta dhe ambienti rregullator, përmirësimi i qasjes në financa, thjeshtësimi i tatimit, promovimi i përdorimit të teknologjive informatike dhe të komunikimit, përmirësimi i sipërmarrësish në arsimin dhe trajnimin, inkurajimi i internacionalizimit, përmirësimi i shërbimeve për zhvillim afarist e kështu me radhë.

3. PËRKRAHAJA FINANCIARE E NVM

Mungesa e fondeve financiare për financimin e aktivitetit afarist është bërë një ndër problemet kronike të ekonomisë së çdo vendi. Fondet e pamjaftueshme financiare ndikojnë edhe në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ekzistuese, por edhe në zgjerimin e tyre dhe në themelimin e ndërmarrjeve të reja. Kuptohet, nëse nisemi nga fakti që përqindja më e madhe e ndërmarrjeve të reja (sidomos në vendet e tranzicionit) atëherë, logjikisht, do të përfundojmë që gjat aktit të themelimit të subjektit të ri afarist, burim i vetëm dhe më i rëndësishëm për financimin e biznesit të mëtutejshëm bazohet në kursimet personale të “themeluesve të ndërmarrjes”, pastaj mjete financiar që sigurohen nga format e ndryshme të huamarrjes, zakonisht nga shokët, miqët, farafisët si dhe nga shumë burime joformale të sigurimit të mjeteve financiare për startimin e sukseshëm të biznesit. Mundësitë e tilla dhe mundësitë e sigurimit financiarë të “**Tregut joformal të kapitalit**”. Është e qartë se në fazat e mëtutejshme të zhvillimit të bizneseve të vogla (faza e suksesit) zmadhohen dhe vazhdimisht shtohen nevojat nga mjetet shumë të nevojshme financiare të cilat mundemi t’i sigurojmë nga “**Institucionet egzistuese formale të financimit**” dhe të cilat, janë të mundshme dhe të dedikuara për financimin e ndërmarrjeve të vogla. Në tabel më poshtë vërejmë se 57.0% e fondeve financiare që përdorin ndërmarrjet e anketuara janë mjete të veta apo nga burimet interne, kurse 43.0% e fondeve janë nga burimet eksterne, përkatësisht nga ato janë kredi bankare 32.1%, hua nga individët dhe familjet 9.8%, fonde financiare pa kthim 0.3%, dhe nga burime të tjera 0.7%. Një strukturë të përafërt të fondeve financiare e vërejmë edhe sipas sektorëve ekonomikë, në prodhim, tregti, dhe shërbime. Është interesante se edhe në krahasim me gjendjen në këtë fushë në vitin 2004, treguesit kanë mbetur pothuaj se të njëjtë. Kështu, mjetet vetjake kanë shënuar një rënie të lehtë prej 0.4% në vitin 2005 në krahasim me vitin 2004, apo nga 57.4% sa ishin ato në vitin 2004, në 57.0% në vitin 2005. Struktura e fondeve financiare nga burimet eksterne që kishin shfrytëzuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në vitin 2005 po ashtu është e ngjashme me atë në vitin 2004, me lëvizje shumë të lehta.

Burimet financiare	Numri total i ndërmarrjeve %	Prodhuese %	Tregtare %	Shërbyese %
Mjete vetanake	57.0	57.1	56.2	58.1
Kredi bankara	32.1	34.3	32.3	30.5
Mjete pa kthim	0.3	0.0	0.0	1.0
Hua (nga familjarët)	9.8	8.6	11.5	8.6
Të tjera	0.7	0.0	0.0	1.9
Totali	100	100	100	100

Burimi: Të dhënat nga anketa e MTI-Departamenti i PZHSP

Pjesëmarrja e lartë e mjeteve financiare nga burimet interne të ndërmarrjeve reflekton vështirësitë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për sigurimin e fondeve financiare optimale brenda sistemit financiar të vendit.

4. ZHVILLIMI REGJIONAL ME THEKS TË VACANT NË R.M.V

Me zhvillimin ekonomik, roli i NVM-ve është bërë gjithnjë më i shquar, ndërsa problemet me zhvillimin e NVM-ve është shpallur gradualisht, kërkimet mbi çështjen e zhvillimit të NVM-ve kanë filluar të rriten, por këto studime rrallë vërejnë zhvillimin afatgjatë të NVM-ve, kryesisht egziston zgjidhje afat-shkurtër për një problem lokal të bazuar. Duke filluar me hapat e para të decentralizimit, komunat e kanë njohur zhvillimin ekonomik lokal si një ingerencë që në masë të madhe mund të ndikojë mbi zhvillimin e përgjithshëm të komunave, por edhe si një masë që

jep shpresë se gjendja e keqe ekonomike e popullatës mund të ndryshohet shumë duke zbatuar projekte lokale dhe rajonale. Politikat të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik lokal dhe planet për realizimin e tyre gjatë periudhës që është lëndë e vëzhgimit me këtë raport janë pjesë e Programit për Zbatimin e Procesit të Decentralizimit dhe Zhvillimit të Vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Maqedonisë 2011-2014 dhe e Programit për Zbatimin e Procesit të Decentralizimit 2008–2010 (PZPD 2008–2010)7 . Këto programe janë të bazuar në qëllime strategjike të reformës së vetëqeverisjes lokale dhe procesit të decentralizimit dhe mbindërtohet në qëllimet e Programit Operativ për Decentralizim 2003–2004 (POD 2003–2004)8, Programi për Zbatimin e Procesit të Decentralizimit 2004–2007 (PZPD 2004–2007)9 dhe Plani i Hollësishëm për Transferimin e Ingerencave dhe Resurseve në Procesin e Decentralizimit (PHTIRPD)10, i cili ishte sjellë në vitin 2005. Ligji për Vetëqeverisje Lokale11 parashikon një listë të ingerencave për të cilat janë përgjegjës komunat. Neni 22, paragrafi 3 i Ligjit e përcakton listën e punëve në zhvillimin ekonomik lokal për të cilat është përgjegjëse komuna, ndërsa Ligji për Qytetin e Shkupit12 (në Nenin 10 dhe 15, paragrafi 3) i parashikon punët që duhet zbatohen nga Qyteti i Shkupit, gjegjësisht komunat e Qytetit të Shkupit, në sajë të ingerencave për zhvillim ekonomik lokal, mes të cilave:

- ✓ Planifikimi i zhvillimit ekonomik lokal;
- ✓ Caktimi i prioriteteve zhvillimore dhe strukturore;
- ✓ Udhëheqje të politikës lokale ekonomike;
- ✓ Mbështetje të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sipërmarrjes në nivelin lokal

Rregullimi ligjor i zhvillimit ekonomik lokal, si ingerencë që duhet të zbatohet komunat, është lidhur ngushtë me legjislaturën që ka të bëjë me ingerenca tjera të shumta që ndikojnë mbi zhvillimin e ZHEL.Në vitin 2011, me rëndësi të madhe për ZHEL-in ishte sjellja ose ndryshimi i rregulloreve të ndryshme ligjore nga fusha e urbanizmit me të cilat ingerenca ishte përhapur, kryesisht me Ligjin për Rregullimin e Objekteve të Paligjshme dhe Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Rregullimin e Objekteve të Paligjshme, si dhe Ligjin për Tokë Ndërtimore dhe Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Tokë Ndërtimore. Sipas Programit për Zbatimin e Procesit të Decentralizimit dhe Zhvillimit të Vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2011-2014, gjatë tre viteve në vijim, “sfida kryesore do të jenë: menaxhimi demokratik në nivel lokal dhe zhvillimi i integruar dhe i qëndrueshëm i njësive për vetëqeverisje lokale. Këto elemente janë veçanërisht të rëndësishëm për krijimin e ambientit për tërheqjen e investimeve, rritjes ekonomike dhe arritjes së zhvillimit që do të kujdeset për aspektet ekonomike, sociale dhe ekologjike në nivel të NJVL“. Themeli i këtij Programi është “me anë të realizimit të masave përkatëse të nxitet zhvillimi më dinamik lokal ekonomik i cili do të ndikojë mbi cilësinë e jetës në njësinë lokale “.

LITERATURË E SHFRYTËZUAR

- Blackburn, R., (2008). Small Business and Entrepreneurship. doi:10.4135/9781446263433. ISBN 9781412934374.
- Carlen, J., (2016) A Brief History of Entrepreneurship: The Pioneers, Profiteers, and Racketeers Who Shaped Our World. Columbia University Press.
- Drucker, P., (1991) Inovacije I preduzenistva, Beograd.
- Katila, R., Chen, E., Piezunka, H., (18 May 2017), Strategic Entrepreneurship. Hoover Institution and Stanford University.
- Kolokovic, M., (2010), Odredenje preduzenistva .Zagreb
- Kushnir., Kh., (2010). A Universal Definition of Small Enterprise. University of Groningen, the Netherlands
- OECD (2016), Financing SMEs and Entrepreneurs: An OECD Scoreboard, OECD Publishing.
- Robo, M., Beqiri, A., (2014) Bazat e sipërmarrjes 2. Tirane.
- Selimi, G., Shujibi, E., (2019) , Sipermarresia.Gostivar.
- Scarborough. N., Cornwal. J., (2005) Essentials of Enterpreneruship and Small Business Menagement. Eight edition.
- Yetisen, A.K., Volpatti L.R., Coskun, A.F., Cho, S., Kamrani, E., Butt, H., Khademhosseini, A., Yun, S.H. (2015) *Entrepreneurship. Lab-on-a-Chip.*
- Enti per punesim dhe regjstri Qendror IRMV.
<http://www.konkurentnost.mk/Alb/OblastiDetailVieWSQ.aspx?oblastid=2>
www.chrisfoxin.com
[http://sbp.org.pk/bd/pd/Handbook-\(iSME\)PDF](http://sbp.org.pk/bd/pd/Handbook-(iSME)PDF)
<http://www.konkurentnost.mk/Alb/OblastiDetailViewSq.aspx?oblastId=2>